



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**

---

**V E N D I M**

**PËR DHËNIE AUTORIZIMI PËR NDRYSHIMIN E VENDNDODHJES TË DISA QV-VE,  
PËR ZGJEDHJET PËR ORGNET E QEVERISJES VENDORE, TË DATËS 30 QERSHOR  
2019**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e tij të datës 03.06.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI -	Kryetar
Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

shqyrtoi çështjen me:

**OBJEKT:** Për dhënien e autorizimit për ndryshimin e vendndodhjes së disa qendrave të votimit, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.

**BAZA LIGJORE:** Neni 23, pika 1, gërma "a", neni 93, pika 2, gërma "a", neni 62, pika 4 e Ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoji diskutimet e të pranishmëve,

**V E R E N**

**Kryetari i Bashkisë Kamëz** me shkresën nr. 5034 prot., datë 31.05.2019 ka kontestuar vendndodhjen e disa qendrave të votimit të bashkisë Kamëz të miratuara me vendimin 651 të KQZ, datë 26.05.2019.

Në komunikim verbal në ambjentet e KQZ me punonjësit e bashkisë Kamëz, propozohen disa ndryshime të vendndodhjeve të QV-ve të kësaj bashkie të cilat u miratuan me vendimin sipërcituar.

1)Vendimi i KQZ për QV nr.1581,1581/1,1581/2 është shkolla "Ibrahim Rugova" e cila shërben dhe si VNV e KZAZ nr 27. Propozohet shkolla "Sulejman Elezi" e cila ndodhet në zonen e QV nr. 1586, ngjitur me zonen e QV 1581, ka distance me të afert se shkolla "Ibrahim Rugova" e cila shërben si ambjent për 6 qendra votimi.

2)Vendimi për QV nr. 1582 dhe 1582/1 është shkolla "Ibrahim Rugova". Pas verifikimit rezultoi se distanca nga qendra e zones së QV nr. 1582 me shkollën "Ibrahim Rugova" është rreth 1800, duke ardhur në rritje deri në 3500m në kufij. Propozohet objekti privat



**Nr. 796 i Vendimit**

**Data 03.06.2019**

**Ora 18:00 e Vendimit**

Për dhënie autorizimi për ndryshimin e vendndodhjes të disa QV-ve, për Zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019

"Marsh Prendi" e cila ka shërbyer si ambient për keto dy QV në zgjedhjet e kaluara, kanë një sipërfaqe prej 50 m<sup>2</sup> secila, gjithashtu pronari i këtyre ambienteve deklaroi se i vë në dispozicion për ngritjen e QV-ve në zgjedhjet e datës 30.06.2019.

3) Vendimi i KQZ, për QV nr.1578 dhe 1578/1 është shkolla "Niko Hoxha", propozohet shkolla "Kamza e Re" e cila ndodhet në zonën e QV nr. 1572, në kufi me zonën e QV nr. 1578 dhe ka një distancë me të afërt se shkolla "Niko Hoxha".

4) Vendimi për QV nr. 1588 dhe 1588/1, 1588/2 është shkolla, "Nënë Tereza". Propozimi i kryetarit të bashkisë është lokal privat "Esat Matraxhi". Keto ambiente kanë shërbyer në disa procese zgjedhore, distanca nga ky ambient deri në shkollën "Nënë Tereza" është 1800 dhe rritet deri në 4500 m në kufijtë e zonës së QV nr. 1588, duke krijuar një distancë të pafavorshme për zgjedhësit.

5) Vendimi i KQZ për QV nr. 2041, 2041/1, 2041/2 dhe 2041/3 është shkolla "Vllazërimi". Propozohet shkolla "Azem Hajdari, pasi distanca në këto shkolle është e përgjysmuar në krahasim me shkollën "Vllazërimi".

### **PËR KËTO ARSYE**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 23, pika 1, gërma "a", neni 93, pika 2, gërma "a", nenin 62, pika 4, të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Udhëzimin nr. 1, datë 12.12.2012 "Për mënyrën e ngritjes dhe caktimit të vendndodhjes së qendrave të votimit dhe përgatitjen e hartës së njësive të qeverisjes vendore për zgjedhjet",

### **V E N D O S I :**

1. Dhënien e autorizimit për ndryshimin e vendndodhjes së QV-ve sipas lidhjes 1 bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Kryetari i Bashkisë të afishojë menjëherë listat e zgjedhësve në vendndodhjet e qendrave të votimit, caktuar me këtë vendim.
3. Kryetari i Njësive të Qeverisjes Vendore të njoftojë menjëherë zgjedhësit, për vendndodhjen e qendrës së votimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda pesë ditëve nga shpallja e tij.

<b>Klement</b>	<b>ZGURI -</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Denar</b>	<b>BIBA -</b>	<b>Zv/Kryetar</b>
<b>Bledar</b>	<b>SKËNDERI-</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Edlira</b>	<b>JORGAQI-</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta</b>	<b>BITRI</b>	<b>Anëtare</b>

